



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR KINEMATOGRAFINË<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON CINEMATOGRAPHY<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O KINEMATOGRAFIJI<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligjit për Kinematografinë është aprovuar në mbledhjen e 113 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 02/113, date 16.12.2022.

<sup>2</sup> Draft Law on Cinematography was approved on the 113th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.02/113 dated 16.12.2022.

<sup>3</sup> Nacrt Zakon o kinematografiji usvojen je na 113 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.02/113, datum 16.12.2022.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR KINEMATOGRAFINË</b></p> <p><b>KAPITULLI I</b> <b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi i ligjit</b></p> <p>Me këtë ligj rregullohet veprimtaria, organizimi, financimi, prodhimtaria, distribuimi dhe shfaqja e veprave filmike në vend dhe jashtë vendit, inkurajimi i krijimtarisë, promovimi, mbrojtja, ruajtja dhe studimi i trashëgimisë kinematografike, zhvillimi, mbështetja, edukimi përmes filmit, promovimi dhe ruajtja e krijimtarisë</p>	<p><b>Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p><b>LAW ON CINEMATOGRAPHY</b></p> <p><b>CHAPTER I</b> <b>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1</b> <b>Purpose of the Law</b></p> <p>This law regulates the activity, organization, financing, production, distribution and displaying of film works in the country and abroad, the encouragement of creation, promotion, protection, preservation and study of the cinematographic heritage, development, support, education through film,</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo,</b></p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O KINEMATOGRAFIJI</b></p> <p><b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1</b> <b>Cilj</b></p> <p>Ovim zakonom uređuje se delatnost, organizacija, finansiranje, proizvodnja, distribucija i prikazivanje filmskih dela u zemlji i inostranstvu, podsticanje stvaralaštva, unapređenje, zaštita, očuvanje i proučavanje kinematografskog nasleđa, razvoj, podrška, edukacija kroz film, promocija i očuvanje</p>
---	---	--

<p>kinematografike, përmes krijimit të kushteve për prodhimin e veprave filmike vendore dhe bashkëprodhimeve ndërkombëtare.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë si dhe institucionet e organizmat e tjerë në Republikën e Kosovës, të cilët kanë të drejta, përgjegjësi dhe autorizime të caktuara në fushën e kinematografisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Për qëllim të këtij ligji, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. <b>Film apo vepër filmike</b> - nënkupton një vepër me pamje me apo pa zë, si filmin e luajtur, animuar dhe dokumentar të çdo metrazhi dhe zhanri;</p> <p>1.2. <b>Vepër audio-vizuale</b> - nënkupton një vepër si: filmin, filmin eksperimental, projektin filmik multimedial dhe transmedial, serialin filmik, videolojërat dhe çdo vepër tjetër me pamje dhe me</p>	<p>promotion and preservation of cinematographic creations, through the creation of conditions for the production of domestic film works and international co-productions.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>The provisions of this law are mandatory for all natural and legal persons as well as other institutions and organizations in the Republic of Kosovo that have certain rights, responsibilities and authorizations in the field of cinematography.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. For the purpose of this law, the expressions used have the following meaning:</p> <p>1.1. <b>Film or film work</b> - means a work with visuals with or without sound, such as played, animated and documentary film of any length and genre;</p> <p>1.2. <b>Audio-visual work</b> - means a work such as: film, experimental film, multi-media and trans-media film project, film series, video games and any other work with visuals and with</p>	<p>kinematografskog stvaralaštva, stvaranjem uslova za proizvodnju domaćih filmskih dela i međunarodnih koprodukcija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2 Delokrug</b></p> <p>Odredbe ovog zakona su obavezujuće za sva pravna i fizička lica kao i druge institucije i organe u Republici Kosovo koji imaju određena prava, odgovornosti i ovlašćenja u oblasti kinematografije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Za potrebe ovog zakona, izrazi koji su korišćeni u ovom zakonu, imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. <b>Film ili filmsko delo</b> – podrazumeva delo sa slikom sa ili bez tona, kao što su igrani, animirani ili dokumentarni film bilo kojeg metraža i žanra;</p> <p>1.2. <b>Audiovizuelno delo</b> - podrazumeva delo kao što su: film, eksperimentalni film, multimedijalni i transmedijalni filmski projekat, filmsku seriju, video igre i svako drugo</p>
--	---	--

<p>apo pa zë, pavarësisht teknologjisë me të cilën është krijuar dhe mënyrës së shfaqjes;</p> <p><b>1.3. Prodhim filmik apo audio-vizual</b> - nënkupton procesin e përgjithshëm të prodhimit dhe aktivitetet e ndërmarra që nga faza e zhvillimit të konceptit, zhvillimit të projektit, paraprodhimit, prodhimit, pasprodhimit, shfaqjes, distribuimit dhe promovimit të veprës;</p> <p><b>1.4. Film vendor</b> - nënkupton:</p> <p>1.4.1. filmin, ku regjisori dhe/ose producenti është shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4.2. filmin ku producenti është person juridik me qëndrim në Republikën e Kosovës dhe pjesëmarrja e autorëve, aktorëve dhe/ose artistëve të tjerë shtetas të Kosovës dhe/ose i kapitalit vendor është e rëndësishme më të madhe;</p> <p>1.4.3. filmin e prodhuar prej një apo më shumë producentëve shtetas të Kosovës, me së paku një autor vendor dhe me pjesëmarrje të konsiderueshme të punëtorëve vendorë të filmit.</p>	<p>or without sound, regardless of the technology with which it was created and the way of display;</p> <p><b>1.3. Film or audio-visual production</b> - means the general production process and the activities undertaken from the stage of concept development, project development, pre-production, production, post-production, display, distribution and promotion of the work;</p> <p><b>1.4. Domestic film</b> - means:</p> <p>1.4.1. the film, where the director and/or producer is a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4.2. the film, where the producer is a legal entity residing in the Republic of Kosovo and the participation of authors, actors and/or other artists who are citizens of Kosovo and/or domestic capital is of the greatest importance;</p> <p>1.4.3. the film produced by one or more Kosovo citizen producers, with at least one domestic author and with significant participation of domestic film workers.</p>	<p>delo sa slikom i sa ili bez tona, bez obzira na tehnologiju kojom je nastalo i način prikazivanja;</p> <p><b>1.3. Filmska ili audio-vizuelna produkcija</b> - podrazumeva opšti proces produkcije i aktivnosti preduzete od faze izrade koncepta, sprovođenja projekta, pretprodukcije, produkcije, postprodukcije, prikazivanja, distribucije i promocije dela;</p> <p><b>1.4. Domaći film</b> – podrazumeva:</p> <p>1.4.1. film, u kojem je režiser i/ili producent državljanin Republike Kosovo;</p> <p>1.4.2. film, u kojem je producent pravno lice sa sedištem u Republici Kosovo i učešće autora, glumaca i/ili drugih umetnika državljana Kosova i/ili domaćeg kapitala je od velikog značaja;</p> <p>1.4.3. film proizveden od strane jednog ili više producenata državljana Kosova, sa najmanje jednim kosovskim autorom i uz značajno učešće domaćih filmskih radnika.</p>
--	--	--

<p>1.5. <b>Serial filmik</b> - nënkupton veprën audio-vizuale të ndarë në episode;</p> <p>1.6. <b>Bashkëprodhim</b> - nënkupton prodhimin filmik të realizuar nga dy ose më shumë prodhues;</p> <p>1.7. <b>Bashkëprodhim mazhoritar</b> - nënkupton veprën filmike apo audio-vizuale ku Republika e Kosovës mbështet financiarisht një projekt ndërkombëtar me jo më pak se 10% dhe jo me shumë se 90% të vlerës së përgjithshme, duke marrë parasysh testin e kulturës;</p> <p>1.8. <b>Bashkëprodhim minor</b> - nënkupton veprën filmike apo audio-vizuale ku Republika e Kosovës mbështet financiarisht një projekt ndërkombëtar me jo më pak se 5% dhe jo më shumë se 20% të vlerës së përgjithshme, duke marrë parasysh testin e kulturës;</p> <p>1.9. <b>Autor</b> - nënkupton personin fizik që e krijon veprën;</p> <p>1.10. <b>Producent</b> - nënkupton personin fizik apo juridik që organizon, udhëheq, mbikëqyr dhe/apo merr përgjegjësi organizative e financiare për prodhimin e veprës filmike apo audio-vizuale;</p>	<p>1.5. <b>Film series</b> - means the audio-visual work divided into episodes;</p> <p>1.6. <b>Co-production</b> - means film production carried out by two or more producers;</p> <p>1.7. <b>Major co-production</b> - means the film or audio-visual work where the Republic of Kosovo financially supports an international project with not less than 10% and not more than 90% of the total value, taking into account the culture test;</p> <p>1.8. <b>Minor co-production</b> - means the film or audio-visual work where the Republic of Kosovo financially supports an international project with no less than 5% and no more than 20% of the total value, taking into account the culture test;</p> <p>1.9. <b>Author</b> - means the natural person who creates the work;</p> <p>1.10. <b>Producer</b> - means the natural or legal person who organizes leads, supervises and/or takes organizational and financial responsibility for the production of a film or an audio-visual work;</p>	<p>1.5. <b>Filmska serija</b> – podrazumeva audiovizuelno delo koje je podeljeno na epizode;</p> <p>1.6. <b>Koprodukcija</b> – podrazumeva filmsku produkciju realizovanu od strane dva ili više producenata;</p> <p>1.7. <b>Većinska koprodukcija</b> - podrazumeva filmsko ili audiovizuelno delo, u kojoj Republika Kosovo finansijski podržava međunarodni projekat sa najmanje 10% i ne više od 90% ukupne vrednosti, uzimajući u obzir test kulture;</p> <p>1.8. <b>Manjinska koprodukcija</b> - podrazumeva filmsko ili audiovizuelno delo, u kojoj Republika Kosovo finansijski podržava međunarodni projekat sa najmanje 5% i ne više od 20% ukupne vrednosti, uzimajući u obzir test kulture;</p> <p>1.9. <b>Autor</b> – podrazumeva fizičko lice koje je stvorilo delo;</p> <p>1.10. <b>Producent</b> - podrazumeva fizičko ili pravno lice, koje organizuje, rukovodi, nadgleda i/ili preuzima organizacionu i finansijsku odgovornost za proizvodnju filmskog ili audiovizuelnog dela;</p>
---	--	---

<p>1.11. <b>Rabat</b> - nënkupton skemën e rimbursimeve financiare për personat juridikë të huaj, të cilët realizojnë vepra filmike apo audio-vizuale në Republikën e Kosovës, përmes investimeve financiare nga jashtë;</p> <p>1.12. <b>Ministria</b> - nënkupton ministrinë përkatëse për kulturë;</p> <p>1.13. <b>Ministri</b> - nënkupton ministrin përkatës të kulturës;</p> <p>1.14. <b>Distributor</b>- nënkupton personin fizik apo juridik që realizon veprime ose shërbime që përkojnë me distribuimin e veprës filmike apo audio-vizuale;</p> <p>1.15. <b>Shfaqës</b> - nënkupton personin fizik ose juridik që bën shfaqjen publike të një vepre filmike apo audio-vizuale në forma të ndryshme;</p> <p>1.16. <b>QKK</b> - nënkupton Qendrën Kinematografike të Kosovës;</p> <p>1.17. <b>Veprimtari plotësuese</b> - nënkupton ruajtjen e trashëgimisë filmike dhe audio-vizuale, festivalet e filmit dhe manifestimet e tjera filmike,</p>	<p>1.11. <b>Rebate</b> - means the scheme of financial reimbursements for foreign legal persons, who create film or audio-visual works in the Republic of Kosovo, through financial investments from abroad;</p> <p>1.12. <b>Ministry</b> - means the relevant ministry for culture;</p> <p>1.13. <b>Minister</b> - means the relevant minister of culture;</p> <p>1.14. <b>Distributor</b> - means the natural or legal person, who performs actions or services, which coincide with the distribution of the film or audio-visual work;</p> <p>1.15. <b>Displayer</b> - means the natural or legal person, who makes a public display of a film or audio-visual work in different forms;</p> <p>1.16. <b>KCC</b> - means the Kosovo Cinematographic Centre;</p> <p>1.17. <b>Complementary activity</b> - means preservation of film and audio-visual heritage, film festivals and other film manifestations; programs</p>	<p>1.11. <b>Rabat</b> - podrazumeva šemu finansijske nadoknade za strana pravna lica, koja ostvaruju filmska ili audiovizuelna dela u Republici Kosovo, kroz finansijske investicije iz inostranstva;</p> <p>1.12. <b>Ministarstvo</b> – podrazumeva relevantno ministarstvo kulture;</p> <p>1.13. <b>Ministar</b> – podrazumeva relevantnog ministra kulture;</p> <p>1.14. <b>Distributor</b> - podrazumeva fizičko ili pravno lice, koje vrši bilo koju radnju ili uslugu, koja odgovara distribuciji filmskog ili audiovizuelnog dela;</p> <p>1.15. <b>Prikazivač</b> - podrazumeva fizičko ili pravno lice, koje obavlja javno prikazivanje filmskog ili audiovizuelnog dela u različitim oblicima;</p> <p>1.16. <b>KCK</b> – podrazumeva Kinematografski centar Kosova;</p> <p>1.17. <b>Dopunska delatnost</b> - podrazumeva očuvanje filmskog i audiovizuelnog nasleđa, filmskih festivala i drugih filmskih</p>
---	---	--

<p>programet e promovimit dhe shitjes së veprave filmike, botimet, hulumtimet, studimet, bashkëpunimet ndërkombëtare si dhe programet e ngritjes profesionale dhe të edukimit, programet e shoqatave dhe organizatave që merren me këtë veprimtari;</p> <p><b>1.18. Materialet e veçanta të arkivueshme</b> - nënkupton të gjitha materialet përcjellëse të veprës filmike apo audio-vizuale me interes për arkivim, siç mund të jenë skenari, libri i xhirimit, fotografitë nga xhirimi ose paraprodhimi, materialet promovuese dhe çfarëdo materiali që ka rëndësi të veçantë nga kostumografia, skenografia, aparatura të përdorura në prodhimin e filmit, rekuizita etj.;</p> <p><b>1.19. Testi i kulturës</b> - nënkupton klasifikimin e kategorive të konkursit për mbështetje financiare në bazë të kriterëve që përcaktohen me akte nënligjore të QKK-së;</p> <p><b>1.20. Regjisor debutues</b> - nënkupton personin fizik që për herë të parë e bën regjinë e një filmi të metrazhit të gjatë;</p>	<p>for the promotion and sale of film works; publications; research; studies; international cooperation; as well as professional development and education programs; programs of associations and organizations dealing with this activity;</p> <p><b>1.18. Special archiveable materials</b> - means all accompanying materials of the film or audio-visual work of interest for archiving, such as the scenario script, the shooting book, photographs from the shooting or pre-production, promotional materials and any material of special importance from costume design, scenography, equipment used in the production of the film, props, etc.;</p> <p><b>1.19. The culture test</b> - means the classification of the categories of the competition for financial support based on the criteria that are determined by the by-laws of the KCC;</p> <p><b>1.20. Debutant director</b> - means the natural person who directs a long length film for the first time;</p>	<p>manifestacija; programe promocije i prodaje filmskih dela; publikacije; istraživanja; studije; međunarodne saradnje; kao i programe stručnog usavršavanja i edukacije; programe udruženja i organizacija koje se bave ovom delatnošću;</p> <p><b>1.18. Posebni arhiviran materijal</b> - podrazumeva sav prateći materijal filmskog ili audiovizuelnog dela od interesa za arhiviranje, kao što su scenario, knjiga snimanja, fotografije sa snimanja ili pretprodukcije, promotivni materijal i bilo koji materijal koji je od posebnog značaja iz kostimografije, scenografije, aparature koja se koristi u filmskoj produkciji, rekviziti itd.;</p> <p><b>1.19. Test kulture</b> - podrazumeva klasifikaciju kategorija konkursa za finansijsku podršku na osnovu kriterijuma koji su utvrđeni podzakonskim aktima KCK-a;</p> <p><b>1.20. Reditelj debitant</b> – podrazumeva fizičko lice koje po prvi put režira dugometražni film;</p>
---	---	---

<p>1.21. <b>Film i metrazhit të shkurtër</b> - nënkupton veprën filmike që zgjat deri në 30 minuta;</p> <p>1.22. <b>Film i metrazhit të mesëm</b> - nënkupton veprën filmike që zgjat nga 30 deri në 60 minuta;</p> <p>1.23. <b>Film i metrazhit të gjatë</b> - nënkupton veprën filmike që zgjat më shumë se 60 minuta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Ushtrimi i veprimtarisë kinematografike</b></p> <p>1. Veprimtaria kinematografike në Republikën e Kosovës konsiderohet fushë e interesit të veçantë publik.</p> <p>2. Veprimtari kinematografike në Republikën e Kosovës mund të ushtrojë çdo person fizik ose juridik.</p> <p>3. Personi juridik vendor ose i huaj ka të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë kinematografike me kushtin që të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.</p>	<p>1.21. <b>Short length film</b> - means a film work lasting up to 30 minutes;</p> <p>1.22. <b>Medium length film</b> - refers to the film work that lasts from 30 to 60 minutes;</p> <p>1.23. <b>Long length film</b> - means a film work that lasts more than 60 minutes.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>The exercising of cinematographic activity</b></p> <p>1. The cinematographic activity in the Republic of Kosovo is considered a field of special public interest.</p> <p>2. The cinematographic activity in the Republic of Kosovo can be exercised by any natural or legal person.</p> <p>3. The domestic or foreign legal person has the right to exercise the cinematographic activity provided that it is registered in the Republic of Kosovo in accordance with the relevant legal provisions.</p>	<p>1.21. <b>Kratkometražni film</b> – podrazumeva filmsko delo koje traje do 30 minuta;</p> <p>1.22. <b>Srednjometražni film</b> – podrazumeva filmsko delo koje traje od 30 do 60 minuta;</p> <p>1.23. <b>Dugometražni film</b> – podrazumeva filmsko delo koje traje više od 60 minuta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Obavljanje kinematografske delatnosti</b></p> <p>1. Kinematografska delatnost u Republici Kosovo smatra se oblašću od posebnog javnog interesa.</p> <p>2. Kinematografsku delatnost u Republici Kosovo može obaviti svako fizičko ili pravno lice.</p> <p>3. Domaće ili strano pravno lice ima pravo da obavlja kinematografsku delatnost pod uslovom da je registrovano u Republici Kosovo u skladu sa relevantnim zakonskim odredbama.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>E drejta për xhirim</b></p> <p>1. Vepra filmike apo audio-vizuale mund të xhirohet kudo në Republikën e Kosovës, përveç nëse parashihet ndryshe me dispozitat e tjera ligjore.</p> <p>2. Nëse xhirimi duhet të bëhet në objektet ose mjediset ku qasja për publik është e kufizuar producenti duhet të kërkojë leje xhirimi nga organi kompetent.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>The right to filming</b></p> <p>1. Film or audio-visual work can be filmed anywhere in the Republic of Kosovo, unless otherwise provided by other legal provisions.</p> <p>2. If the filming must be done in facilities or environments, where access to the public is limited, the producer must request a filming permit from the competent body.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Pravo na snimanje</b></p> <p>1. Filmsko ili audiovizuelno delo može se snimati bilo gde u Republici Kosovo, osim ako je drugačije predviđeno drugim zakonskim odredbama.</p> <p>2. Ako snimanje treba da se vrši u objektima ili prostorijama gde je pristup javnosti ograničen, producent treba da zatraži dozvolu za snimanje od nadležnog organa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Institucionet përgjegjëse për kinematografi</b></p> <p>1 Institucionet përgjegjëse për kinematografi janë:</p> <p>1.1. Ministria për Kulturë, e cila përcakton politikat e përgjithshme të zhvillimit të kinematografisë dhe ndan mjete buxhetore për realizimin e tyre;</p> <p>1.2. QKK-ja si institucion i shërbimit publik në kuadër të Ministrisë e cila është përgjegjëse për zhvillimin e kinematografisë në Republikën e Kosovës;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Institutions responsible for cinematography</b></p> <p>1 Institutions responsible for cinematography are:</p> <p>1.1. The Ministry of Culture, which determines the general policies for the development of cinematography and allocates budget funds for their implementation;</p> <p>1.2. The KCC as a public service institution within the Ministry, which is responsible for the development of cinematography in the Republic of Kosovo;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Odgovorne institucije za kinematografiju</b></p> <p>1. Odgovorne institucije za kinematografiju su:</p> <p>1.1. Ministarstvo kulture, koje utvrđuje opšte politike razvoja kinematografije i izdvaja budžetska sredstva za njihovu realizaciju;</p> <p>1.2. KCK kao institucija javnih usluga u okviru Ministarstva, koja je odgovorna za razvoj kinematografije u Republici Kosovo;</p>

1.3. Institucionet e tjera të nivelit qendror apo lokal të cilat ndihmojnë fushëveprimtarinë e kinematografisë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë.

**Neni 7  
Kosovafilmi**

Ndërmarrja Shoqërore “Kosovafilm” e themeluar në vitin 1969 si kompani për prodhimin, shfaqjen dhe distribuimin e filmit, me të gjitha të drejtat pronësore dhe intelektuale, është njësi e posaçme në Qendrën Kinematografike të Kosovës.

**Neni 8  
Përgjegjësitë e Qendrës Kinematografike të Kosovës**

1. Qendra Kinematografike e Kosovës (tani e tutje QKK) ka këto autorizime dhe përgjegjësi:

1.1. është autoritet qendror për kinematografi që nxit dhe mbështet financiarisht veprimtarinë kinematografike, me qëllim të realizimit të politikave kinematografike në shërbim të interesit publik të Republikës së Kosovës;

1.3. Other institutions at the central or local level, which help the activities of cinematography, within their fields of responsibility.

**Article 7  
Kosovafilm**

The Social Enterprise “Kosovafilm” founded in 1969 as a company for the production, displaying and distribution of the films, with all property and intellectual rights, is a special unit in the Kosovo Cinematographic Centre.

**Article 8  
Responsibilities of the Kosovo  
Cinematographic Centre**

1. The Kosovo Cinematographic Centre (hereafter KCC) has the following authorizations and responsibilities:

1.1. It is the central authority for cinematography, which promotes and financially supports cinematographic activities, with the aim of implementation of cinematographic policies in the service of the public interest of the Republic of Kosovo;

1.3. Druge institucije na centralnom ili lokalnom nivou koje pomažu delatnost u oblasti kinematografije, u okviru svojih oblasti odgovornosti.

**Član 7  
Kosovafilm**

Društveno preduzeće „Kosovafilm“ je osnovano 1969. godine kao kompanija za proizvodnju, projekciju i distribuciju filma, sa svim imovinskim pravima i intelektualnom svojinom, i predstavlja posebnu jedinicu u Kinematografskom centru Kosova.

**Član 8  
Odgovornosti Kinematografskog  
centra Kosova**

1. Kinematografski centar Kosova (u daljem tekstu KCK) ima ova ovlašćenja i odgovornosti:

1.1. KCK je centralni organ za kinematografiju, koji podstiče i finansijski podržava kinematografsku delatnost, u cilju realizacije kinematografske politike u službi javnog interesa Republike Kosovo;

<p>1.2. promovon kinematografinë e Kosovës në festivalet dhe tregjet e filmit në vend dhe jashtë vendit, si dhe organizon, mbështet dhe merr pjesë në ngjarje të tjera që i shërbejnë promovimit dhe zhvillimit të kinematografisë;</p> <p>1.3. ka kod të veçantë buxhetor dhe i menaxhon financat e saj;</p> <p>1.4. bashkëpunon me institucionet, organizatat publike dhe private, si dhe asociacionet vendore dhe të huaja në të gjitha çështjet me interes për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillimin e kinematografisë, përfshirë edhe edukimin përmes filmit;</p> <p>1.5. bashkëpunon me autoritete homologe të vendeve të tjera, bashkëpunon dhe aderon në mekanizmat rajonalë dhe ndërkombëtarë, inicion dhe nënshkruan marrëveshje nga fusha e kinematografisë;</p> <p>1.6. merr përsipër gjithë përgjegjësinë për zbatimin e masave përkatëse për ruajtjen, konservimin, dokumentimin dhe prezantimin e trashëgimisë kinematografike në Republikën e Kosovës në cilësinë e institucionit që trashëgon të drejtat dhe detyrimet nga të</p>	<p>1.2. It promotes Kosovo cinematography in festivals and film markets in the country and abroad, and organizes, supports and participates in other events that serve to the promotion and development of cinematography;</p> <p>1.3. It has a specific budget code and manages its own finances;</p> <p>1.4. It cooperates with institutions, public and private organizations, as well as local and foreign associations in all matters of interest to create a favourable environment for the development of cinematography, including education through films;</p> <p>1.5. It cooperates with counterpart authorities of other countries, cooperates and adheres to regional and international mechanisms, initiates and signs agreements in the field of cinematography;</p> <p>1.6. It assumes all responsibility for the implementation of relevant measures for the preservation, conservation, documentation and presentation of the cinematographic heritage in the Republic of Kosovo in the capacity of the institution that</p>	<p>1.2. promovise kinematografiju Kosova na filmskim festivalima i tržištima u zemlji i inostranstvu, kao i organizuje, podržava i učestvuje u drugim događajima koji služe promociji i razvoju kinematografije;</p> <p>1.3. ima poseban budžetski kod i upravlja svojim finansijama;</p> <p>1.4. sarađuje sa institucijama, javnim i privatnim organizacijama, kao i domaćim i stranim udruženjima u svim pitanjima od interesa za stvaranje povoljnog okruženja za razvoj kinematografije, uključujući i edukaciju kroz film;</p> <p>1.5. sarađuje sa partnerskim institucijama drugih zemalja, sarađuje i pristupa regionalnim i međunarodnim mehanizmima, pokreće i zaključuje sporazume u oblasti kinematografije;</p> <p>1.6. Preuzima punu odgovornost za sprovođenje relevantnih mera za očuvanje, konzervaciju, dokumentovanje i prezentaciju kinematografskog nasleđa u Republici Kosovo u svojstvu institucije koja nasleđuje prava i obaveze od svih</p>
---	---	--

<p>gjithë institucionet e tjera me bazë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe të drejtat që rrjedhin nga e drejta e pronësisë intelektuale;</p> <p>1.7. merret me zhvillimin, mbrojtjen, restaurimin, përpunimin, ruajtjen, arkivimin, promovimin, dhe bën të mundur qasjen dhe shfrytëzimin e kësaj trashëgimie, ku përfshihen edhe koleksionet e dokumenteve të shkruara arkivore, literaturës dhe materialeve të tjera arkivore me interes për kinematografinë;</p> <p>1.8. mirëmban arkivin e filmit, kinotekën, bibliotekën dhe arkivin e materialeve të veçanta të kinematografisë;</p> <p>1.9. mirëmban sistemet për arkivin e filmave në shirit dhe medime tradicionale, arkivin digjital dhe të mediave në zhvillim, arkivin dhe bibliotekën e materialeve të shkruara arkivore për film, arte e disiplina që janë të lidhura me artin filmik;</p> <p>1.10. siguron zbatimin e masave për mbledhjen, mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e trashëgimisë audio-vizuale, duke respektuar standardet e</p>	<p>inherits the rights and obligations from all other institutions based in the Republic of Kosovo, including the rights arising from intellectual property rights;</p> <p>1.7. It deals with the development, protection, restoration, processing, preservation, archiving, promotion, and makes possible the access and use of this heritage, which also include collections of written archival documents, literature and other archival materials of interest to cinematography;</p> <p>1.8. It maintains the film archive, the cinemathèque, the library and the archive of special cinematographic materials;</p> <p>1.9. It maintains systems for the film archive on tape and traditional media, digital and emerging media archive, archive and library of written archival materials for films, arts and disciplines related to the film arts;</p> <p>1.10. It ensures the implementation of measures for the collection, protection, preservation and processing of audio-visual heritage, respecting the standards set by the</p>	<p>drugih institucija sa sedištem u Republici Kosovo, uključujući i prava koja proizilaze iz prava intelektualne svojine;</p> <p>1.7. Bavi se razvojem, zaštitom, restauracijom, obradom, očuvanjem, arhiviranjem, promocijom, i omogućava pristup i korišćenje ovog nasleđa, gde su uključene i zbirke pisanih arhivskih dokumenata, literature i druge arhivske građe od interesa za kinematografiju;</p> <p>1.8. Održava filmsku arhivu, kinoteku, biblioteku i arhivu posebne kinematografske građe;</p> <p>1.9. Održava sisteme za filmsku arhivu na traci i tradicionalnim medijima, digitalnu i medijsku arhivu u razvoju, arhivu i biblioteku pisane arhivske građe za film, umetnost i discipline vezane za filmsku umetnost;</p> <p>1.10. Obezbeđuje sprovođenje mera za prikupljanje, zaštitu, očuvanje i obradu audiovizuelnog nasleđa, poštujući standarde koje je postavila</p>
--	---	---

<p>përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Arkivave të Filmit – FIAF;</p> <p>1.11. mbledh, mbron, përpunon dhe ruan filmat e trashëguar të produksionit të ish – Ndërmarrjes Shoqërore “Kosovafilm” për çka mban të gjitha të drejtat si prodhues dhe/ose të drejtat e tjera të specifikuara për secilin prodhim filmi e vepre audio-vizuale;</p> <p>1.12. mbledh, mbron, përpunon dhe ruan filmat e përkrahur financiarisht nga QKK-ja, filmat e prodhuesve të pavarur të Kosovës, filmat e studentëve, regjistrimet audio-vizuale të prodhuar nga institucionet e kulturës në Kosovë dhe regjistrimet e tjera audio-vizuale me interes kulturor, që konsiderohen si trashëgimi kulturore e Kosovës, të prodhuara nga institucionet e tjera kulturore në kuadër të Ministrisë ose nga cilido institucion ose organizatë tjetër që funksionon me buxhetin e Kosovës;</p> <p>1.13. mbledh, mbron, përpunon dhe ruan filmat dhe materialet audio-vizuale, me interes kulturor për Republikën e Kosovës, të cilët i koleksionon, me marrëveshje, nga arkivat rajonale e ndërkombëtare;</p>	<p>International Federation of Film Archives - FIAF;</p> <p>1.11. It collects, protects, processes and preserves the inherited films of the production of the Former Kosovafilm Social Enterprise, for which it holds all the rights as a producer and/or other rights specified for each film and audio-visual work production.</p> <p>1.12. It collects, protects, processes and preserves films financially supported by the KCC, films of independent producers of Kosovo, films of students, audio-visual recordings produced by cultural institutions in Kosovo and other audio-visual recordings of cultural interest, which are considered as the cultural heritage of Kosovo, produced by other cultural institutions within the Ministry or by any other institution or organization that operates with the budget of Kosovo;</p> <p>1.13. It collects, protects, processes and preserves films and audio-visual materials, of cultural interest for the Republic of Kosovo, which it collects, by agreement, from regional and international archives;</p>	<p>Međunarodna federacija filmskih arhiva – FIAF;</p> <p>1.11. Prikuplja, štiti, obrađuje i čuva nasleđene filmove produkcije bivšeg Društvenog preduzeća Kosovafilm, za koje ima sva prava kao producent i/ili druga prava precizirana za svaku filmsku produkciju i audiovizuelno delo;</p> <p>1.12. Prikuplja, štiti, obrađuje i čuva filmove koje finansijski podržava KCK, filmove nezavisnih producenata Kosova, filmove studenata, audiovizuelne snimke koje proizvode kulturne institucije na Kosovu, i druge audiovizuelne snimke od kulturnog interesa, koji se smatraju kulturno nasleđe Kosova, proizvedeno od drugih kulturnih institucija u okviru Ministarstva ili bilo koje druge institucije ili organizacije koja funkcioniše sa budžetom Kosova;</p> <p>1.13. Prikuplja, štiti, obrađuje i čuva filmove i audiovizuelni materijal, od kulturnog interesa za Republiku Kosovo, koje prikuplja, po dogovoru, iz regionalnih i međunarodnih arhiva;</p>
--	---	---

<p>1.14. ofron mbrojtje profesionale dhe ligjore, përmes procedimit dhe ruajtjes së arkivave audio – vizuale publike apo private/familjare që janë me interes për trashëgiminë kulturore të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.15. ndërton raporte bashkëpunimi me arkiva të tjera për të bërë mbrojtjen dhe ruajtjen e kopjeve të filmave dhe prodhimeve të tjera audio-vizuale të arkivave të vendeve të tjera, dhe në mënyrë reciproke të japë për ruajtje kopje të filmave dhe materialeve të tjera audio-vizuale nga fondi i vet;</p> <p>1.16. ofron regjistrimet e veprave audio-vizuale nga fondi i vet për qëllime hulumtimi, edukative ose promovuese institucioneve arsimore ose palëve të tjera, me kusht që këto të fundit të kenë dëshminë për të drejtën e shfrytëzimit nga pronarët e të drejtave autoriale për shfrytëzimin e veprës ose materialit audio-vizual, në rastet kur kjo gjë është e nevojshme sipas ligjeve në fuqi;</p> <p>1.17. administron kinotekën e vet që shërben për shfaqjen e veprave filmike apo audio-vizuale të organizuara si shfaqje tematike, projeksione me qëllime</p>	<p>1.14. It offers professional and legal protection, through the processing and storage of public or private/family audio-visual archives that are of interest to the cultural heritage of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.15. It builds cooperative relationships with other archives to protect and preserve copies of films and other audio-visual productions of the archives of other countries, and to reciprocally provide for preservation copies of films and other audio-visual materials from the own fund;</p> <p>1.16. It offers recordings of audio-visual works from its own fund for research, educational or promotional purposes, to educational institutions or other parties, provided that the latter have proof of the right of use from the copyright owners for the use of the work or audio-visual material, in cases where this is necessary according to the laws in force;</p> <p>1.17. It administers its own cinematheque that serves for the displaying of film or audio-visual works organized as thematic displays,</p>	<p>1.14. Pruža profesionalnu i pravnu zaštitu, kroz obradu i čuvanje javnih ili privatnih/porodičnih audiovizuelnih arhiva, koje su od interesa za kulturno nasleđe Republike Kosovo;</p> <p>1.15. Uspostavlja odnose saradnje sa drugim arhivima radi zaštite i očuvanja kopija filmova i druge audiovizuelne produkcije arhiva drugih zemalja, i recipročno obezbeđuje očuvanje kopija filmova i drugog audiovizuelnog materijala iz sopstvenog fonda;</p> <p>1.16. Pruža snimke audiovizuelnih dela iz sopstvenog fonda u istraživačke, obrazovne ili promotivne svrhe, obrazovnim institucijama ili drugim licima, pod uslovom da ovi zadnji imaju dokaz o pravu korišćenja od nosilaca autorskih prava za korišćenje dela ili audiovizuelnog materijala, u slučajevima kada je to neophodno u skladu sa važećim zakonima;</p> <p>1.17. upravlja sopstvenom kinotekom koja služi za prikazivanje filmskih ili audiovizuelnih dela organizovanih kao tematske projekcije, projekcije u</p>
---	--	---

<p>studimore ose projeksione që janë pjesë e bashkëpunimit me institucione brenda ose jashtë Republikës së Kosovës dhe që kanë për qëllim zhvillimin, promovimin, studimin apo përkrahjen e kinematografisë ose projekteve që lidhen me kinematografi.</p> <p>2.Struktura dhe organizimi i brendshëm i QKK-së rregullohet me akt nënligjor në përputhje me ligjin përkatës për organizimin e administratës shtetërore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9 Organet drejtuese</b></p> <p>1. Organet drejtuese të QKK-së janë:</p> <p>1.1. Këshilli profesional;</p> <p>1.2. Drejtori.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10 Këshilli profesional i QKK-së</b></p> <p>1. Këshilli profesional i QKK-së (tani e tutje Këshilli) përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.</p>	<p>projections with study purposes or projections that are part of cooperation with institutions inside or outside the Republic of Kosovo and that aim to develop, promote, study or support the cinematography or projects related to cinematography.</p> <p>2.The structure and internal organization of the KCC is regulated by a by-law in accordance with the relevant law on the organization of the state administration.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9 Governing bodies</b></p> <p>1. The governing bodies of the KCC are:</p> <p>1.1. Professional council;</p> <p>1.2. The director.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10 The professional council of the KCC</b></p> <p>1. The professional council of the KCC (hereafter the Council) consists of five (5) members and has a four (4) year mandate, with the possibility of re-election.</p>	<p>studijske svrhe ili projekcije koje su deo saradnje sa institucijama unutar ili van Republike Kosovo i koje imaju za cilj razvoj, promovisanje, proučavanje ili podrška kinematografiji ili projektima koji se odnose na kinematografiju.</p> <p>2. Struktura i unutrašnja organizacija KCK-a uređuju se podzakonskim aktom u skladu sa relevantnim Zakonom o organizaciji državne uprave.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9 Upravni organi</b></p> <p>1. Upravni organi KCK-a su:</p> <p>1.1. Stručni savet;</p> <p>1.2. Direktor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10 Stručni savet KCK-a</b></p> <p>1. Stručni savet KCK-a (u daljem tekstu Savet) čine pet (5) članova i ima mandat od četiri (4) godine, uz mogućnost ponovnog izbora.</p>
---	--	---

<p>2. Këshilli i QKK-së përbëhet nga personalitete të shquara nga fusha e kinematografisë dhe e kulturës.</p> <p>3. Këshilli i QKK-së emërohet dhe shkarkohet nga ministri.</p> <p>4. Dy anëtarë zgjidhen nga ministri, njëri nga ta është përfaqësues i Ministrisë, njëri nga fusha kinematografisë.</p> <p>5. Tre (3) anëtarë të tjerë zgjidhen nga propozimet e shoqatave aktive dhe komuniteti i filmbërësve, sipas ftesës së ministrit.</p> <p>6. Këshilli i QKK-së i raporton ministrit.</p> <p>7. Anëtarët zgjedhin nga radhët e veta kryesuesin e Këshillit të QKK-së.</p> <p>8. Anëtarët e Këshillit të QKK-së nuk mund të jenë në marrëdhënie të rregullt pune në QKK.</p> <p>9. Anëtarët e Këshillit të QKK-së nuk mund të jenë anëtarë të jurisë vlerësuese apo komisioneve të QKK-së.</p> <p>10. Anëtarët e Këshillit kompensohen për punën e tyre.</p>	<p>2. The Council of the KCC consists of prominent personalities from the field of cinematography and culture.</p> <p>3. The Council of the KCC is appointed and dismissed by the Minister.</p> <p>4. Two members are elected by the minister, one of them is a representative of the Ministry, one from the field of cinematography.</p> <p>5. Three (3) other members are elected from the proposals of active associations and the community of filmmakers, according to the Minister's invitation.</p> <p>6. The KCC Council reports to the Minister.</p> <p>7. The members elect among themselves the Chairman of the Council of the KCC.</p> <p>8. Members of the KCC Council cannot be in a regular employment relationship with the KCC.</p> <p>9. Members of the KCC Council cannot be members of the evaluation jury or commissions of the KCC.</p> <p>10. The Council members are compensated for their work.</p>	<p>2. Savet KCK-a çine istaknute ličnosti iz oblasti kinematografije i kulture.</p> <p>3. Savet KCK-a imenuje i razrešava ministar.</p> <p>4. Dva člana bira ministar, jedan od njih je predstavnik ministarstva, jedan je iz oblasti kinematografije.</p> <p>5. Ostala tri (3) člana biraju se na predlog aktivnih udruženja i zajednice filmskih stvaralaca, po pozivu ministra.</p> <p>6. Savet KCK-a izveštava ministru.</p> <p>7. Članovi iz svojih redova biraju predsedavajućeg Saveta KCK-a.</p> <p>8. Članovi Saveta KCK-a ne mogu biti u redovnom radnom odnosu u KCK-u.</p> <p>9. Članovi Saveta KCK-a ne mogu biti članovi ocenjivačkog žirija ili komisija KCK-a.</p> <p>10. Članovi Saveta dobijaju naknade za svoj rad.</p>
--	--	--



<p align="center"><b>Neni 11</b> <b>Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të QKK-së</b></p>	<p align="center"><b>Article 11</b> <b>Duties and responsibilities of the KCC Council</b></p>	<p align="center"><b>Član 11</b> <b>Dužnosti i odgovornosti Saveta KCK-a</b></p>
<p>1. Këshillon ministrin për politikat zhvillimore të QKK-së.</p> <p>2. Mbikëqyr dhe vlerëson zbatimin e politikave zhvillimore të QKK-së. Harton raporte dhe rekomandime mbi efektshmërinë e zbatimit të politikave aktuale dhe masave që duhet të ndërmerren nga Ministria në funksion të avancimit të kinematografisë.</p> <p>3. Merr pjesë në procesin e hartimit të legjislacionit në fushën e kinematografisë.</p> <p>4. Këshillon drejtorin në përzgjedhjen e jurive dhe të komisioneve të QKK-së.</p> <p>5. Ofron këshilla profesionale për mbarëvajtjen e punës së QKK-së.</p> <p>6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit dhe mënyra e kompensimit rregullohen me akt nënligjor të aprovuar nga ministri.</p>	<p>1. Advises the Minister on the development policies of the KCC.</p> <p>2. Supervises and evaluates the implementation of the development policies of the KCC. Drafts reports and recommendations on the effectiveness of the implementation of current policies and measures to be taken by the Ministry for advancing of the cinematography.</p> <p>3. Participates in the process of drafting legislation in the field of cinematography.</p> <p>4. Advises the Director in the selection of juries and commissions of the KCC.</p> <p>5. Offers professional advice for the smooth running of the work of the KCC.</p> <p>6. The duties and responsibilities of the Council, the method of compensation is regulated by a sub-legal act approved by the Minister.</p>	<p>1. Savetuje ministra u vezi razvojnih politika KCK-a.</p> <p>2. Nadgleda i ocenjuje sprovođenje razvojnih politika KCK-a. Izrađuje izveštaje i preporuke o efikasnosti sprovođenja aktuelnih politika i mera koje treba da preduzme Ministarstvo u cilju unapređenja kinematografije.</p> <p>3. Učestvuje u procesu izrade zakonodavstva u oblasti kinematografije.</p> <p>4. Savetuje direktora u izboru žirija i komisija KCK-a.</p> <p>5. Daje stručne savete za obavljanje poslova u KCK-u.</p> <p>6. Dužnosti i odgovornosti Saveta, način nadoknade uređuju se podzakonskim aktom, koji donosi ministar.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Zgjedhja e Drejtorit të QKK-së</b></p> <p>1. Drejtori i QKK-së zgjidhet përmes procesit të konkursit publik.</p> <p>2. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të QKK-së organizohet nga Ministria në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Election of the Director of the KCC</b></p> <p>1. The director of the KCC is elected through a public competition process.</p> <p>2. The election procedure of the Director of the KCC is organized by the Ministry in accordance with this law and the legislation in force.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Izbor direktora KCK-a</b></p> <p>1. Direktor KCK-a se bira putem procesa javnog konkursa.</p> <p>2. Postupak izbora direktora KCK-a sprovodi ministar u skladu sa ovim zakonom i važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Kriteret për përzgjedhjen e Drejtorit të QKK-së</b></p> <p>1. Kandidati për Drejtor të QKK-së duhet të plotësojë kriteret minimale si në vijim:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. të ketë shtetësi të Republikës së Kosovës;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. të ketë përvojë pune profesionale në fushën e kinematografisë ose kulturës, dhe përvojë pune në pozita drejtuese;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3 të ketë njohuri të përgjithshme në fushën e kulturës, veçanërisht në fushën e kinematografisë;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Të ketë program dhe vizion për kinematografinë dhe menaxhimin</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Criteria for the election of the Director of the KCC</b></p> <p>1. The candidate for KCC Director must meet the following minimum criteria:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Must have citizenship of the Republic of Kosovo;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Must have professional work experience in the field of cinematography or culture, and work experience in management positions;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Must have general knowledge in the field of culture, especially in the field of cinematography;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Must have a program and vision for cinematography and the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Kriterijumi za izbor direktora KCK-a</b></p> <p>1. Kandidat za direktora KCK-a treba da ispuni sledeće minimalne kriterijume:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Da ima državljanstvo Republike Kosovo;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Da ima stručnog radnog iskustva u oblasti kinematografije ili kulture, i radnog iskustva u rukovodećim pozicijama;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Da poseduje opšte znanje u oblasti kulture, posebno u oblasti kinematografije;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Da ima program i viziju za kinematografiju i upravljanje</p>

<p>e zhvillimin e QKK-së;</p> <p>1.5. Kriteret e tjera për Drejtor përcaktohen me konkurs, bazuar me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Detyrat e Drejtorit të QKK-së</b></p> <p>1. Drejtori i QKK-së është organi kryesor menaxhues dhe drejtues dhe ka këto detyra:</p> <p>1.1. udhëheq, koordinon dhe organizon punën e përgjithshme dhe organizative të institucionit në funksion të realizimit të suksesshëm të veprimtarisë;</p> <p>1.2. ushtron përgjegjësinë e organit më të lartë ekzekutiv brenda institucionit;</p> <p>1.3. prezanton dhe përfaqëson institucionin në të gjitha rastet përveç kur përcaktohet ndryshe me ligj;</p> <p>1.4. bashkëpunon me Këshillin me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve në funksion të përmbushjes së objektivave të QKK-së, apo politikave programore;</p>	<p>management and development of the KCC;</p> <p>1.5. Other criteria for the Director are set out by competition, based on the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Duties of the Director of the KCC</b></p> <p>1. The Director of KCC is the main managing and leading body and has the following duties:</p> <p>1.1. Leads, coordinates and organizes the general and organizational work of the institution in function of the successful implementation of the activity;</p> <p>1.2. Exercises the responsibility of the highest executive body within the institution;</p> <p>1.3. Presents and represents the institution in all cases, except when otherwise determined by law;</p> <p>1.4. Cooperates with the Council to coordinate the activities in order to fulfil the objectives of the KCC or program policies;</p>	<p>razvojem KCK-a;</p> <p>1.5. Ostali kriterijumi za direktora utvrđuju se konkursom, na osnovu Zakona na snazi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Dužnosti direktora KCK-a</b></p> <p>1. Direktor KCK-a je glavni upravni i rukovodeći organ i ima ove dužnosti:</p> <p>1.1. Rukovodi, koordinira i organizuje opšti i organizacioni rad institucije u cilju uspešne realizacije delatnosti;</p> <p>1.2. Snosi odgovornost najvišeg izvršnog organa u instituciji;</p> <p>1.3. Predstavlja i zastupa instituciju u svim slučajevima osim ako zakonom nije drugačije utvrđeno;</p> <p>1.4. Saraduje sa Savetom u cilju koordinacije aktivnosti u funkciji ispunjavanja ciljeva KCK-a, ili programskih politika;</p>
--	---	--

